



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja nr. **16/2024**

Data: **25 shkurt, 2025. Ora: 13:30**

Vendi: **Selia e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

Kryesues i KQZ-së: Kreshnik Radoniqi

Anëtarët e KQZ-së: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana

Në takim ishin të Llaban, Qemailj Kurtis, Mufera Shinik

pranishëm:

U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP: Besnik Buzhala

Përkthyes: Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes Nr. 12 dhe 13/2025

3. Aktivitetet e SKQZ

4. Këshillat e KQZ

4.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore

4.1.1. Shqyrtimi dhe miratimi i Procedurës për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve

4.2. Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

4.2.1. Shqyrtimi dhe miratimi i ftesës për mbledhjen e 13 të bordit ekzekutiv të A-ËEB, e cila do të mbahet në Manila, Filipine, nga data 24 deri 27 prill 2025.

4.2.2. Shqyrtimi dhe miratimi i pagesës së anëtarësisë së A-ËEB për vitin 2025.

5. Të ndryshme

1. Hyrje

z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KOZ-së: Kryetari Radoniqi, paraqiti agjendën e takimit e cila, u miratua me vota unanime. Gjithashtu, në vazhdim u miratuan edhe procesverbalet e mbledhjeve nr. 12 dhe 13/2025 1o vota për, dhe 1 abstenim .

2. Aktivitetet e SKQZ:

Një raport të gjerë të pasqyrimin të rrjedhës së kompletimit të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të 9 shkurtit për Kuvend, e paraqiti drejtori i Sekretariatit, Besnik Buzhala. Lidhur me procesin e numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), ai tha se numërimi për kandidatë për vendvotimet e rregullta ka filluar me datën 11.02.2025 dhe ka përfunduar me datën 21.02.2025. Numërimi në QKN është realizuar për 2533 vendvotime të rregullta.

Një proces tjetër, ka qenë pranimi i materialeve zgjedhore nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) që ka filluar me datën 19.02.2025, i cili ka vazhduar në datat 20.01.2025, 21.02.2025, 22.02.2025 dhe 23.02.2025, ku me këtë datë është realizuar pranimi i materialeve zgjedhore nga QKN në Komunën e Zubin Potokut. Të gjitha materialet që janë pranuar në QNR, janë përcjellë nën mbikëqyrjen e Policisë së Kosovës.

Ndërsa, sa i përket kamerave që kanë qenë të vendosura në vendvotime dhe në QKN, pjesë më e madhe e tyre janë transportuar në bodrumin e ndërtesës së ish-Rilindjes, e cila mbikëqyret nga kamerat e sigurisë, në të cilën kanë qasje zyrtarët policor të Policisë së Kosovës.

Për rrjedhojë të procesit, z. Buzhala tha në këtë mbledhje se gjatë procesit të pranimit, disa komuna nuk i kanë paketuar materialet zgjedhore në kuti të votimit sipas procedurave, si: Gjakova (145 kuti të votimit, Gjilani (1 kuti të votimit), Prishtina (75 kuti të votimit), Prizren (3 kuti të votimit), Ferizaj (1 kuti të votimit) dhe Skenderaj (7 kuti të votimit). Pra, me vendim të Drejtorit të SKQZ, komisioni në përbërje të tetë (8) zyrtarëve nga SKQZ kanë bërë hapjen e gjithsejtë: 232 kutie të votimit. Arsyeja e mos paketimit ka qenë se brenda kutive të votimit janë futur materialet, si: Formularët e ndryshëm dhe librat e votimit, të cilat materiale është dashur të paketohen jashtë kutive të votimit, konkretisht të përfshihen në zarfin A3, i cili vendoset mbi çdo kapat të kutive të votimit. Prandaj, veprimi ynë me këto kuti, ka shpjeguar Buzhala, është vëzhguar nga kamerat, si dhe kanë qenë të ftuara subjektet politike të certifikuara për vëzhgim të këtij procesi.

Përgjatë procesit, është bërë edhe skanimi i listave përfundimtare të votuesve në QNR, skanimi i çdo nënshkrimi në listat përfundimtare të votuesve, me qëllim të nxjerrjes së statistikave për votuesit që kanë shfrytëzuar të drejtën e votës në ditën e zgjedhjeve, më 9 shkurt 2025. Ky proces ka filluar ditën e shtunë, me datën 22.02.2025. Me datën 22.02.2025 dhe 23.02.2025, skanimi i LPV është zhvilluar në vetëm me një ndërrim. Ndërsa, procesi i skanimit ka vazhduar me datën 24.05.2025 në dy ndërrime. Nga data 22.02.2025 deri me datën 25.02.2025, ora 12:00, procesi i skanimit ka përfunduar për gjashtë (6) komuna ose shprehur në përqindje, 35.13% të vendvotimeve janë skanuar listat përfundimtare të votuesve (890 nga 2,533 vendvotime).

Në vazhdim të raportimit në KQZ, z. Buzhala ka thënë se vlerësimi i zarfeve me fletëvotime të dërguara në kutitë postare të KQZ jashtë Kosovës, ka filluar me datën 09.02.2025 dhe ka përfunduar me datën 24.02.2025. Nga 68,712 zarfe të dërguara në kutitë postare të KQZ: 62,990 zarfe janë aprovuar, 4,865 zarfe janë refuzuar, dhe 131 zarfe kanë mbërritur gabimisht në adresën e KQZ (në kutitë postare).

Në kontekst, 729 zarfe nuk janë vlerësuar pasi aplikuesit kishin zgjedhur të votonin fizikisht në përfaqësitë diplomatike. Për vlerësimin e këtyre zarfeve, është e nevojshme skanimi i listës së votuesve të përfaqësive diplomatike, për të mundësuar krahasimin dhe shmangien e votimit të dyfishtë. Arsyet e refuzimit të 4,865 zarfeve: 1. 2,870 zarfe nuk janë proceduar, pasi votuesit ishin të anuluar gjatë fazës së aplikimit për regjistrim si votues jashtë Kosovës (29 gusht 2024 – 26 dhjetor 2024), 310 zarfe janë refuzuar, pasi fletëvotimi nuk ka qenë i personalizuar (një person – një fletëvotim), 3. 24 zarfe janë refuzuar, pasi nuk kanë pasur pullë/vulë postare, 4.138 zarfe janë

refuzuar, pasi votuesit i kanë dërguar nga një shtet tjetër nga ai që kishin deklaruar gjatë regjistrimit, 178 zarfe janë refuzuar, pasi brenda tyre ka qenë vetëm dëftesa e regjistrimit, pa fletëvotim, 432 zarfe janë refuzuar, pasi brenda tyre ka munguar dëftesa e regjistrimit dhe kanë përmbajtur vetëm fletëvotimin, 45 zarfe janë refuzuar, pasi votuesit kanë dërguar fletëvotimin me dokument identifikues të Kosovës dhe nuk kanë përfshirë dëftesën e regjistrimit, dhe 868 zarfe janë refuzuar, pasi votuesit kanë dërguar zarfin me fletëvotim më shumë se një herë.

Kutitë e votimit që përmbajnë fletëvotimet e vlerësuara, e të cilat janë dërguar dhe mbledhur nga kutitë postare të KQZ, transportohen sot, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, ka thënë në fund të raportit z. Buzhala.

Diskutime:

Ilir Gashi, tha se duhet të trajtohen edhe disa çështje që kanë ndodh. Një nga to, është objekt i hetimit të prokurorisë. Unë kërkoj që Sekretariati ta formojë një komision që ta hetojë kutinë nr. 020607 në Gjakovë që mendohet se ka “qarkullue treni bullgar”! Ajo kuti është numëruar por unë kërkoj të largohet nga rezultati dhe të bëhet një hetim, pavarësisht nga prokuroria. Edhe kutia 11/0207 në Mitrovicë, edhe për këtë duhet të formohet një komision...! Edhe verifikimi i votave të diasporës, do të duhej të formohet një komision që votat e dyfishta, personat që kanë votuar dy herë, të hetohen. Këto, duhet të bëhen objekt i prokurorisë, pavarësisht si është bërë keqpërdorimi.

Kemi edhe një çështje: votimin në QKUK ku është bërë deri në ora 11:00 me procedurë antiligjore. Votimet mbyllen në ora 19:00 sipas ligjit, dhe ne as nuk jemi njoftuar. Zyrtarja e KKK-së ka dërguar ekipin pas mbylljes së vendvotimeve...

Alban Krasniqi: Ky vlerësim i njëanshëm, politikë dhe jo profesional i kolegut të them se, për në Gjakovë organet janë duke u marrë, dhe ne s’kemi pse formojmë komision tjetër. Ne veprojmë sipas raportit të organeve të hetuesisë. Sa i përket rastit të Mitrovicës, ata kanë dërguar një raport dhe se kutia ka problem teknikë, dhe jo tjetër. Në bazë të raportit, është një gabim i mundshëm dhe, nuk ka dyshim tjetër. Çdo veprim, të jetë profesional dhe jo i dëshirave sepse, çdo proces zgjedhorë ka gabime dhe ne jemi këtu për ti ndërmarrë veprimet. Këto deklarata, ma shumë e dëmtojnë reputacionin e institucionit.

Një gjë tjetër, madje që është edhe për kërkim falje se shumë qytetarë me nevoja të veçanta nuk kanë mundur me votua. Pra, shërbimet nuk janë ofrue, nuk kanë funksionue. Në Prishtinë janë fillua shërbimet në ora 18:30 të mbrëmjes ! Pra, a mos e ka ndalë ndokush ? Por, nuk duhet të merremi me teori konspirative, sado që shërbimi për personat me nevoja të veçanta nuk ka funksionar si duhet...Por, kolegu nuk po e përmend, ndërsa unë them se edhe kjo duhet të jetë pjesë e çfarëdo raporti...

Ilir Gashi: Nuk a koha për teori...! Unë vetëm e ngrita një çështje, pra nëse ka mundësi që ne ti evitojmë sepse, në fund të ditës këto bëhen objekt trajtimi në PZAP. Kjo ke arsyeja, sepse ka fakte, sepse janë gjet fletëvotimet, a ka kontaminim të fletëvotimeve draft. Pse jo, mund ta shqyrtojmë... Çështja e votimit në QKUK: kjo është çështje ligjore. Si mund të votosh në ora 11:00 kur vendvotimet janë mbyllur në ora 19:00. Ne, vetë duhet ti shqyrtojmë këto raste. Kjo, vlen edhe për diasporën, njësoj: pse ka ardhur deri aty.. Nuk mund ti lëmë të rrjedhin sikur nuk ka ndodhur asgjë...?

Ibrahim Selmanaj: Në mbledhjen e KOZ-it i kemi diskutue edhe rastin e Gjakovës dhe të Mitrovicës. Kemi kërkuar raport të detajuar ! Po, kemi diskutuar edhe për 868 zarfet e refuzuara. Edhe këtu, na duhet një analizë detaje: pse është veprua kështu, pse dy herë, qysh a puna sepse kjo, mbi të gjitha, është vepër penale...

Kreshnik Radoniqi: A fillon nesër numërimi i votave të diasporës...?

Besnik Buzhala: Po nesër.

Sami Kurteshi: Cilat vota numërohen ?

Besnik Buzhala” Votat e personave që kanë votuar fizikisht në diasporë...!

3. Këshillat e KOZ

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i Procedurës për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve:

Arianit Elshani: KOZ-i, e ka shqyrtuar. Janë kërkuar disa ndryshime, janë plotësua ato dhe, ne rekomandojmë për miratim...

Sami Kurteshi: Në disa QKN, duket se është një defekt teknik: mendoj që të bëhet në mënyrë uniforme bartja ose transmetimi i fletëvotimeve në ekrane. Ka pasur tavolina numërimi ku fletëvotimi ka qenë i vogël, ose nuk është dukur fare...Kjo, mund të bëhet. E kam vërejte këtë difekt. Ekрани, është për vëzhgues...

Alban Krasniqi: Numërimi që do të bëhet në QNR do të bëhet me kamera, në ekran. Do të prezantohet çdo fletëvotim, dhe platforma e rezultatit si për subjektin dhe kandidatin. Do të regjistrohet i gjithë rezultati...

Sami Kurteshi pyeti se, sa tavolina janë në QNR...?

Arianit Elshani: Ende se kemi draftin por, mbi qo e më tej...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për miratimin e Procedurës për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve ?

Me 11 vota për, miratohet.

4. Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

1.Shqyrtimi dhe miratimi i pagesës së anëtarësisë së A-WEB për vitin 2025:

Me 11 vota për, miratohet pa debat...

2.Shqyrtimi dhe miratimi i ftesës për mbledhjen e 13 të bordit ekzekutiv të A-WEB, e cila do të mbahet në Manila, Filipine, nga data 24 deri 27 prill 2025:

Kreshnik Radoniqi: E kemi edhe një ftesë. E kemi shqyrtuar... Në këshill jemi dakorduar për të shkuar unë, dhe si propozim është edhe Albani. A ka diskutim...? Nëse nuk ka, kush është për...?

Me 9 vota për, miratohet...

5. Të ndryshme !

